



**Prishtinë: 28.12.2012**

**Kodi i ZRRE-së: V\_494\_2012**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_881\_11\_12**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_881\_11\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 05.12.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2012 nxorri këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin Gj.B (shifra në KEK: DGJ - 11710), nga Gjakova, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_881\_11\_12 i datës 12.11.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 28.06.2012 për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 3224638 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 62272834, si dhe po ashtu kanë konstatuar se njehsori elektrik duhet të dërgohet në kalibrim për verifikim. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 28.06.2012 kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori me shifër DGJ - 1170 dhe kanë konstatuar se banesa është e zbrazët dhe nuk banon askush, si dhe nuk ka asnjë pajisje në këtë banesë.

Me datë 14.06.2012 konsumatori ka bërë një kërkesë në Departamentin për konsumator në KEK me të cilën e ka informuar KEK-un se është pronar i ligjshëm i paluejtshmërisë së banesës me nr. 163 A, kati i V (pestë), në sipërfaqe prej  $S = 35.48m^2$ , dhe njëkohësisht ka kërkuar nga KEK-u që t'i shlyej të gjitha borxhet e energjisë elektrike të cilat janë krijuar nga një uzurpator i quajtur V.B dhe të më lejoj që të bëjë ndërrimin e njehsorit ekzistues me njehsor të ri.

Pas parashtrimit të ankesës nga ana e konsumatorit në KEK, Departamentin për Konsumator në KEK me datë 30.07.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit, mbështetur në dokumentin e AKP-së (Agjensionit Kosovar të Pronave) me nr. Ref.0024/2012 BB, të datës 06.03.2012, kontratën e shitblerjes e lidhur me datë 20.02.2012 si dhe certifikatën e pronësisë me nr. Ref. 952-01/235/12, të datës 06.03.2012, si dhe në përgjigje kanë theksuar se bazuar në vendimin e lëshuar nga AKP-së konsumatorit i takon që t'i kontestohet vlera prej 2,203.59€, pra deri me datën kur pronari i ka pranuar çelësat nga AKP-ja, konkretisht pas largimit të uzurpatorit. Gjithashtu nga KEK është theksuar se sa i përket kontestimit të borxhit ju citojmë



nenin 5 të kontratës së shitblerjes së banesës e cila garanton se në paluejtshmërinë e shitur nuk ekziston kurrfarë barre juridike e evidentuar që pengon shitblerjen e kësaj paluejtshmërie, e nëse të njëjtat paraqiten, shitësi detyrohet që të njëjtat t'i eliminoj me shpenzime vetanake.

Pas përgjigjes së KEK-ut, konsumatori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 12.11.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj nga borxhi i krijuar në vlerë prej 3,347.25€, si pasojë e mos pagesës së energjisë elektrike dhe uzurpimit të banesës dhe ka vendosur që vlerën e njëjtë duhet ta ngrijë si kontest deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. Ndërsa në pikën 2 të vendimit ka kërkuar që KEK-u duhet të kërkoj borxhin e krijuar në vlerë prej 3,347.25€, nga uzurpatori V.B dhe atë në procedurë gjyqësore.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së me datë 04.12.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që DMK, gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë një interpretim të njëanshëm të provave, gjithashtu KEK, kundërshton që pas datës 17.05.2012, se nuk ka fakte se nga kjo datë a ka qenë i uzurpuar objekti, si dhe kundërshtimi tjetër nga ana e KEK-ut, se procesverbali i nxjerr nga Gjykata ka qenë një konstatim i gabuar nga shkak se me procesverbalin e datës 30.05.2012, datë e shikimit të vendit të ngjarjes, konstaton në mënyrë paushallë se uzurpatori ka qenë deri më datën 02.05.2012.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28 dhjetor 2012 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, gjithashtu vlerësimin se procesverbali i lëshuar nga Gjykata Komunale ka nxjerr një konstatim të gabuar. Bordi i ZRRE-së konstaton se pretendimet e KEK të theksuara në ankesë nuk tregojnë dhe nuk argumentojnë saktë shkeljet e bëra nga DMK. Bordi i ZRRE-së konstaton se ZRRE nuk ka mandat të merret me validitetin apo jo të procesverbaleve të lëshuara nga Gjykata Komunale, përkundër që i ka fal besimin që procesverbali i gjykatës është një proces zyrtar dhe valid pasi që në këtë është konstatuar një gjendje reale sa i përket pronës së cekur më lartë, andaj edhe si i tillë është i pranueshëm për ZRRE.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe të gjitha dokumentacionet e lëshuara nga ana e Agjencisë Kosovare të Pronës me të cilën dëshmon se si uzurpator i kësaj prone ka qenë V.B. Këtë fakt e vërteton më së miri Dokumenti i lëshuar nga AKP-ja, më datë 17.07.2012. Gjithashtu Gjykata Komunale e Gjakovës në procesverbalin e lëshuar me datë 30.05.2012 me të cilin theksohet se shfrytëzues i kundërligjshëm i banesës ka qenë V.B deri më datë 02.05.2012.

Bordi i ZRRE-së konsideron se DMK ka vepruar konform dispozitave ligjore në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit Gj.B me të cilën ka kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj nga borxhi i krijuar në vlerë prej 3,347.25€, si pasojë e mos pagesës së energjisë elektrike dhe uzurpimit të banesës, dhe ka vendosur që vlerën e njëjtë duhet ta ngrijë si kontest deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. Ndërsa në pikën 2 ka kërkuar që KEK-u duhet të kërkoj borxhin e krijuar në vlerë prej 3,347.25€, nga uzurpatori V.B dhe atë në procedurë gjyqësore.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana



e DMK-së gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirrur në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_881\_11\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar